



VJET SHTET

DEMOKRACIA, SISTEMI MË I MIRË I QEVERISJES

ANISA (11), BLENDI (11), BLEND A (10), ELSA (10), ARBENITA (10), ERON (11), ERIGON (10)



Demokracia është sistemi më i mirë i qeverisjes, sepse populli vendos vet për të ardhmen e tij

Demokracia për herë të parë është shfaqur në vitin 507 para erës sonë. Atëherë nuk kishte demokraci të plotë, sepse vetëm të pasurit dhe burrat kishin të drejtën e votimit, ndërsa të varfërit dhe gratë nuk e kishin këtë të drejtë. Ndërsa, në ditët që jetojmë sot, kemi demokraci më të plotë, sepse të gjithë qytetarët kanë të drejtën e votës mbi moshën 18 vjeçare. Sot, po ashtu zbatohen më shumë të gjitha parimet e demokracisë, të cilat janë: liria, paqja, respekti, toleranca, shprehja e lirë e mendimit, edukimi, bashkëpunimi, solidariteti, të drejtat, barazia, sinqeriteti etj. Edhe shteti ynë Kosova, është shtet i pavarur dhe demokratik, sepse i zbaton parimet e cekura më lart. Asnjëherë nuk duhet harruar se të gjithë qytetarët duhet të kontribuojnë në zbatimin e parimeve të demokracisë, sepse vetëm kështu shteti ynë mund të funksionoj në mënyrën më

të mirë të mundshme.

Janë të njohura dy lloje të demokracisë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe demokracia përfaqësuese. Tek demokracia e drejtpërdrejtë vendimet merren aty për aty, ndërsa tek demokracia përfaqësuese, populli del dhe voton dhe zgjedhen përfaqësuesit apo deputetët e popullit.

Qytetarë të nderuar, ne nxënësit e klasës së 5-të nga shkolla fillore „Zenel Hajdini“ ju ftojmë që edhe ju t'i respektoni sa më shumë parimet e demokracisë. Demokracia është sistem aq i mirë i qeverisjes, dhe nëse të gjithë punojmë shumë, do të arrijmë që të kemi një të ardhme edhe më të mirë.

Pra, populli e ka fuqinë më të madhe për të vendosur për të ardhmen e tij, sepse voton dhe zgjedh deputetët që do ti përfaqësojnë interesat e tyre në „Shtëpinë e Popullit“ pra në Kuvend. Mesazhi ynë është: respekto veten tënde duke i respektuar parimet e demokracisë.



Është kënaqësi të jetosh me parimet e demokracisë




Gazetarët e demokracisë



Në vendet demokratike e drejta për të qenë vetëvetja është e drejtë thelbësore



Pema e demokracisë



Këtu kemi paraqitur disa elemente të demokracisë



Disa nga përfaqësuesit e popullit



Këta përfaqësues punojnë në Kuvend

VENDI KU NXIRREN LIGJET

BLEART (10), DRILONI (10), FLORITA (11), LEON (11), ELMA (11), VANESA (10), ÇIËETA (10), EJUP (10)

Ne jemi nxënës të klasës të V/1 dhe sot jemi bërë gazetarë të demokracisë. Në këtë artikull, keni mundësinë të lexoni dhe të mësoni diçka të re për Kuvendin e Kosovës

Sot pasi u bëmë gazetarë në Punëtoritë e Demokracisë filluam të diskutojmë për Kuvendin e Kosovës. Ne jetojmë në një vend demokratik. Demokracia është qeverisje nga populli. Populli bën zgjedhjet me votën e lirë, të cilat nuk janë as detyra e as obligime. Ato njihen si përgjegjësi e qytetarëve. Pasi ne votojmë zgjedhet Kuvendi dhe deputetët. Në Kuvendin e Kosovës punojnë 120 deputetë. Në Kuvend bëhen edhe disa zgjedhje tjera p.sh.: zgjedhet Kryetari i Kuvendit, Presidenti, Kyeministri, i cili më pastaj formon Qeverinë etj. Në Kuvend aprovohen ose miratohen ligjet, pra Kuvendi është vendi ku nxirren ligjet.

Pastaj dërgohen në Kuvend për t'u miratuar. Në fund kur miratohen kthehen në Qeveri për t'u zbatuar.

Ne kemi mësuar se Kuvendi ka tri funksione kryesore. Ka funksion përfaqësues, sepse Kuvendi përfaqëson popullin, ka funksion legjislativ që do të thotë ligjvënës dhe që miraton ligje, si dhe ka funksion kontrollues që kontrollon Qeverinë. Kuvendi kontrollon Qeverinë me anë të pyetjeve ndaj Kryeministrit dhe ministrave. Këto pyetje shpesh ngjajnë me debatet tona në klasë. Më së shumti ne debatojmë për qeverisjen e klasës. Ne diskutojmë përse të tjerët sillen ndryshe kur mësuesja nuk është në klasë. Këto mosmarrëveshje i rregullojmë duke biseduar me njëri-tjetrin dhe duke rënë dakord me mendimet tona. Ne dëshirojmë të themi se puna e një gazetari është shumë e këndshme dhe e vlefshme për të forcuar demokracinë.



Ky është funksioni përfaqësues



Këtu kemi paraqitur funksionin kontrollues



Grupi i gazetarëve të sotëm




Ndërsa këtu kemi funksionin legjislativ të Kuvendit

ZGJEDHJET DEMOKRATIKE

ALMEDINA (11), EDJON (10), ENES (10), GRANIT (10), GENTRIT (11), LIBERTA (10), MELISA (10),

RREZART (10)



Zgjedhjet e lira i konsiderojmë ato zgjedhje që janë në përputhje me Kushtetutën

Shumë të dashur lexues, në artikullin tonë do të informoheni më shumë rreth zgjedhjeve. Së pari duam t'iu tregojmë për zgjedhjet e përditshmërisë. Si për shembull, kur jemi duke u vonuar për në shkollë dhe jemi me ngut, ne zgjedhim shpejt se çka do të veshim në mënyrë që mos të humbasim orën e mësimi.

Por çka janë zgjedhjet, pse janë të rëndësishme si dhe çfarë lloje të zgjedhjeve kemi ne në vendin tonë do të informoheni gjatë artikullit. Zgjedhjet e lira janë shprehje universale e një vendi demokratik, ku marrja e pushtetit realizohet me mjete paqësore. Kosova, është ndër ato vende që zhvillon zgjedhjet demokratike sepse qytetarët mbi moshën 18 vjeçare janë të lirë që të votojnë për atë që mendojnë se është më i miri dhe mund t'i përfaqësoj më së miri nevojat e tyre si qytetarë.



Këtu kemi paraqitur grupin tonë

Por ai që udhëheq vendin tonë duhet t'i ketë këto cilësi: të jetë shtetas i vendit tonë, të ketë aftësi komunikimi, të jetë transparent dhe fleksibil, i ndershëm, parimor, etj. Në Kosovë kemi dy lloje të zgjedhjeve ato janë: zgjedhjet lokale dhe zgjedhjet qendrore. Në zgjedhjet lokale, qytetarët votojnë për kryetarin e komunës dhe asambleistët. Ndërsa në zgjedhjet qendrore zgjedhim deputetët, të cilët kanë mandat 4 vjeçar.

Të gjithë të zgjedhurit e popullit kanë për obligim që t'i dëgjojnë brengat që qytetarët i kanë në mënyrë që të gjithë të kenë një të ardhme me të mirë. Pra, përfaqësuesit duhet t'i mbrojnë të drejtat e qytetarëve dhe të vendosin për të mirën e tyre. Për këtë, zgjedhjet janë shumë të rëndësishme.

Udhëheqësi nëse tregohet i pavëmendshëm dhe nuk i merr parasysh problemet e qytetarëve vështirë se do t'i fitoj zgjedhjet e ardhshme. Prandaj, ne, duhet të jemi të kujdesshëm për atë që do e votojmë.



Autorët e artikullit të zgjedhjeve



IMPRESUM

demos ti

Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga

TOKA

Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:

Tel: +381 38 704 560

E-mail: info@demos-ti.org

Website: www.demos-ti.org

SHFMU „Zenel Hajdini“

Klasa: 5/1

Vendi: Prishtinë